



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1710/ 6 prot.

Datë 04/08/2025

V E N D I M
Nr. 999/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/08/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*GREEN ENERGY*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-52166-06-23-2025, me objekt: “*Pastrimi i ambjenteve të jashtme të APD-së për 3 vjet*”, me fond limit 52.352.379,69 (pesëdhjetë e dy milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë, presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 534.207,96 (pesëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 25.07.2025, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*GREEN ENERGY*” SHPK me NIPT: M12315008E dhe me adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Rreshit Petrela” Kompleksi “Usuluga”, kati 2, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës.

Adresa: Lagja 1, Rruga "Tregtare", Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*".

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-52166-06-23-2025, me objekt: “*Pastrimi i ambjenteve të jashtme të APD-së për 3 vjet*”, me fond limit 52.352.379,69 (*pesëdhjetë e dy milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë, presje gjashtëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH ose 534.207,96 (*pesëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatë presje nëntëdhjetë e gjashtë*) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 25.07.2025, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 30.06.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5493 dhe me numër protokoll nr. 1710/2025 prot., datë 30.06.2025 e operatorit ekonomik “*GREEN ENERGY*” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datë 01.07.2025, operatori ekonomik ankimues “*GREEN ENERGY*” SHPK ka ridërguar mëpërmjet sistemit elektronik të ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës të administruar me numër ankimi elektronik A/2025/5493 dhe me numër protokoll nr. 1710/2025 prot., datë 30.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1710/1 prot, datë 01.07.2025.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresën nr. 2119 prot, datë 09.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1710/2 prot, datë 11.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*GREEN ENERGY*” SHPK,

në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin e plotësisht të ankesës, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Kërkimi i autoritetit kontraktor lidhur me kriterin “Licencë me kod VII.5.2. Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse”, jo vetëm nuk është në proporcion me qëllimet dhe frymën e ligjit, por përcaktimi se pikërisht subjekti pjesëmarrës duhet të disponojë këtë licencë pikërisht me vendndodhje në adresën e autoritetit kontraktor është kufizuese dhe favorizon të vetmin subjekt, i cili ushtron aktivitetin e tij pikërisht në adresën e autoritetit kontraktor.

ARSYETIMI

Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", autoriteti kontraktor është i detyruar të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të mos ngushtojë konkurrencën në mënyrë artificiale.

Sipas nenit 36 të ligjit 162/2020 specifikimet teknike duhet të lidhen në mënyrë të qartë dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kontrata në fjalë ka për objekt pastrimin e ambienteve të jashtme të portit, që nuk përfshin drejtpërdrejt grumbullimin, transportin apo trajtimin e vajrave të anijeve, të cilat janë mbetje të rrezikshme dhe kërkojnë një aktivitet të veçantë sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Procedura e shpallur nga APD konsiston në pastrimin e tokës e për rrjedhojë edhe në evadimin e mbetjeve të gjeneruara në zonën tokësore. Të gjitha detyrimet për kryerjen e kësaj veprimtarie mbulohen nëpërmjet licencës III.2.B "Për transportim, grumbullim, të mbetjeve", kodeve përkatëse të cituara në kushtet e veçanta të dokumentacionit të publikuar nga APD në sistemin elektronik të prokurimit publik dhe lejes III.1.B, me ID 5.9 "Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë të magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik qëndron, pasi licenca e kërkuar me kod VII.5.2 mbulon një veprimtari e cila zhvillohet në mjedisin detar dhe konsiston në tërheqjen e mbetjeve të ngurta ose vajore nga anijet. Në zbatim të udhëzimit Nr. 2526, datë 23.05.2016 "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre", neni 9 "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto-Romano dhe në radat e tyre

perkatëse", citohen kërkesat, kushtet që kompanitë duhet të plotësojnë si edhe veprimtaria që do të kryejnë.”.

Pra, licenca VII.5.2 lidhet me veprimtarinë që zhvillohet në zonën detare dhe në radat portuale dhe si e tillë ndonëse përbën një dokumentacion të vlefshëm në fushën portuale, nuk përbën një parakusht të domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve të keësaj kontrate të veçantë.

Sipas kreut II "Veprimtaritë që licencohen në fushën e shërbimeve portuale dhe autoriteti kompetent për lëshimin e tyre", nenit 3 "Veprimtaritë që licencohen" përcakton shumë qartë faktin që porti i Durrësit dhe Porto-Romano kanë një licencë të veçantë ndryshe nga portet e tjera. Edhe pse kjo licencë nuk është e kufizuar vetëm për operatorët me seli në port, mënyra se si është formuluar kriteri ndikon në ngushtimin e numrit të operatorëve që kanë mundësi të konkurrojnë dhe heqja e këtij kriteri do të krijonte hapësira më të gjera për pjesëmarrje në garë, duke i shërbyer qëllimit të procedurës për të nxitur konkurrencën dhe për garantuar barazi mes operatorëve ekonomikë.

Për sa mësipër pranohet ankesa e Operatorit Ekonomik (OE).

Së dyti, në dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor në sistemin SPE mungon preventivi i punimeve në të cilën të specifikohen zërat, totali i tyre ashtu siç parashikohet edhe nga legjislacioni.

Në VKM-në nr. 285, date 19.05.2021 parshikon në Nenin 14 të saj:

Neni 14 : Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit:

a) APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

b) Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarte të tenderit sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomike, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo kqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

Në sistemin e SPE-se shihet qartazi mungesa e preventivit si një dokument përbërës i dokumentave të tenderit. Kjo mungesë e dokumentacionit në sistem sjell një pengesë për operatorët ekonomik pjesëmarrës në mënyrë që ata të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Nga ana e autoritetit kontraktor është ngarkuar vetëm një dokument me emërtimin "Termet e referencës", i cili analizon punën që do të kryhet, objektivat, afatin mjete apo elemente të tjerë, por në

asnjë pikë të saj nuk është paraqitur preventivi i punimeve për objektin e prokurimit publik. Mungesa e këtij dokumentacioni sjell për operatorët ekonomik pjesëmarrës paqartësi dhe mangësi në plotësimin e ofertës së tyre ekonomike.

ARSYETIMI:

Pas verifikimit në sistemin SPE, rezulton se dokumentacioni teknik i hedhur nga Autoriteti Kontraktor nuk përmban preventivin e detajuar të zërave të punimeve, siç kërkohet në nenin 14 të VKM nr. 285/2021, ku specifikohet qartë se dokumentet standarde të tenderit duhet të përmbajnë përshkrimin e plotë të punimeve, përfshirë vlerësimet financiare që shërbejnë për hartimin e plotë të punimeve, përfshirë vlerësimet financiare që shërbejnë për hartimin e ofertës ekonomike nga operatorët pjesëmarrës.

Në funksion të garantimit të barazisë dhe transparencës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendosi që Autoriteti Portual Durrës të plotësojë dokumentacionin e tenderit me preventivin përkatës, për të siguruar një konkurrim të hapur dhe të drejtë, dhe për të përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e ligjit të prokurimit publik.

Për sa më sipër pranohet ankesa e OE që preventivi të shtohet.

Nr.	Përdhkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Ditë Pune	Çmimi/Njësi	Vlera Vjetore
1	Sheshe te para	m2				
a.	Pastrim 7 ditë në javë me mjete të zakonshme pastrimi	m2	72,024.00	365.00		
b.	Pastrimi dy (2) ditë në javë me mjet teknologjik me fshesë	m2	72,024.00	104.00		
2	Sheshe të dyta	m2				
a.	Pastrim 2 (dy) ditë në javë me mjete të zakonshme pastrimi	m2	199,212.00	104.00		
b.	Pastrimi 1 ditë në javë me mjet teknologjik me fshesë	m2	187,974.00	52.00		
3	Mirëmbajtje e Shesheve te pa sistemuar	m2	69,201.00	365.00		
4	Lagje me ujë e rrugëve për 3 muaj	m2	52,322.00	93.00		

5	<i>Mirëmbajtja e përditshme e konteniereve sanitarë</i>	<i>copë</i>	3.00	365.00		
6	<i>Pastrim mirëmbajtje e gropave septike</i>	<i>copë</i>				
a.	<i>PMNZSH</i>	<i>copë</i>	1.00	48.00		
b.	<i>Drejtoria</i>	<i>copë</i>	1.00	12.00		
c.	<i>Ofiçina</i>	<i>copë</i>	1.00	12.00		
7	<i>Largimi i mbetjeve urbane</i>	<i>m3</i>	15.00	365.00		
8	<i>Pastrimi i njollave të vajit</i>		2.00	12.00		
<i>TOTALI PA TVSH PËR</i>						
<i>TOTALI PA TVSH PËR TRE VITE</i>						

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*GREEN ENERGY*” SHPK për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*” të shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objket ankimi lidhur me heqjen e kërksës si në vijim: “*Licence me kod VII.5.2 “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse*”, si dhe lidhur me kërkesën e ankimuesit për publikimin e preventivit të shërbimeve objekt prokurimit, të parashtruara nga ana e në formularin e ankesës së ankimit me numër ankimi elektronik A/2025/5493 dhe me numër protokoli nr. 1710/2025 prot., datë 30.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresën nr. 2119 prot, datë 09.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1710/2 prot, datë 11.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*GREEN ENERGY*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin e plotësisht të ankesës, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Kërkimi i autoritetit kontraktor lidhur me kriterin “Licencë me kod VII.5.2. Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse”, jo vetëm nuk është në proporcion me qëllimet dhe frymën e ligjit, por përcaktimi se pikërisht subjekti pjesëmarrës duhet të disponojë këtë licencë pikërisht me vendndodhje në adresën e autoritetit kontraktor është kufizuese dhe favorizon të vetmin subjekt, i cili ushtron aktivitetin e tij pikërisht në adresën e autoritetit kontraktor.

ARSYETIMI

Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", autoriteti kontraktor është i detyruar të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të mos ngushtojë konkurrencën në mënyrë artificiale.

Sipas nenit 36 të ligjit 162/2020 specifikimet teknike duhet të lidhen në mënyrë të qartë dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kontrata në fjalë ka për objekt pastrimin e ambienteve të jashtme të portit, që nuk përfshin drejtpërdrejt grumbullimin, transportin apo trajtimin e vajrave të anijeve, të cilat janë mbetje të rrezikshme dhe kërkojnë një aktivitet të veçantë sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Procedura e shpallur nga APD konsiston në pastrimin e tokës e për rrjedhojë edhe në evadimin e mbetjeve të gjeneruara në zonën tokësore. Të gjitha detyrimet për kryerjen e kësaj veprimtarie mbulohen nëpërmjet licencës III.2.B "Për transportim, grumbullim, të mbetjeve", kodeve përkatëse të cituara në kushtet e veçanta të dokumentacionit të publikuar nga APD në sistemin elektronik të prokurimit publik dhe lejes III.1.B, me ID 5.9 "Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë të magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik qëndron, pasi licenca e kërkuar me kod VII.5.2 mbulon një veprimtari e cila zhvillohet në mjedisin detar dhe konsiston në tërheqjen e mbetjeve të ngurta ose vajore nga anijet. Në zbatim të udhëzimit Nr. 2526, datë 23.05.2016 "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre", neni 9 "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto-Romano dhe në radat e tyre përkatëse", citohen kërkesat, kushtet që kompanitë duhet të plotësojnë si edhe veprimtaria që do të kryejnë.”.

Pra, licenca VII.5.2 lidhet me veprimtarinë që zhvillohet në zonën detare dhe në radat portuale dhe si e tillë ndonëse përbën një dokumentacion të vlefshëm në fushën portuale, nuk përbën një parakusht të domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve të keësaj kontrate të veçantë.

Sipas kreut II "Veprimtaritë që licencohen në fushën e shërbimeve portuale dhe autoriteti kompetent për lëshimin e tyre", nenit 3 "Veprimtaritë që licencohen" përcakton shumë qartë faktin që porti i Durrësit dhe Porto-Romano kanë një licencë të veçantë ndryshe nga portet e tjera. Edhe pse kjo licencë nuk është e kufizuar vetëm për operatorët me seli në port, mënyra se si është formuluar kriteri ndikon në ngushtimin e numrit të operatorëve që kanë mundësi të konkurrojnë dhe heqja e këtij kriteri do të krijonte hapësira më të gjera për pjesëmarrje në garë, duke i shërbyer qëllimit të procedurës për të nxitur konkurrencën dhe për garantuar barazi mes operatorëve ekonomikë.

Për sa mësipër pranohet ankesa e Operatorit Ekonomik (OE).

Së dyti, në dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor në sistemin SPE mungon preventivi i punimeve në të cilën të specifikohen zërat, totali i tyre ashtu siç parashikohet edhe nga legjislacioni.

Në VKM-në nr. 285, date 19.05.2021 parshikon në Nenin 14 të saj:

Neni 14 : Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit:

a) APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

b) Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarte të tenderit sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomike, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo kqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

Në sistemin e SPE-se shihet qartazi mungesa e preventivit si një dokument përbërës i dokumentave të tenderit. Kjo mungesë e dokumentacionit në sistem sjell një pengesë për operatorët ekonomik pjesëmarrës në mënyrë që ata të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Nga ana e autoritetit kontraktor është ngarkuar vetëm një dokument me emërtimin "Termat e referencës", i cili analizon punën që do të kryhet, objektivat, afatin mjete apo elemente të tjerë, por në asnjë pikë të saj nuk është paraqitur preventivi i punimeve për objektin e prokurimit publik. Mungesa e

këtij dokumentacioni sjell për operatorët ekonomik pjesëmarres paqartësi dhe mangësi në plotësimin e ofertës së tyre ekonomike.

ARSYETIMI:

Pas verifikimit në sistemin SPE, rezulton se dokumentacioni teknik i hedhur nga Autoriteti Kontraktor nuk përmban preventivin e detajuar të zërave të punimeve, siç kërkohet në nenin 14 të VKM nr. 285/2021, ku specifikohet qartë se dokumentet standarde të tenderit duhet të përmbajnë përshkrimin e plotë të punimeve, përfshirë vlerësimet financiare që shërbejnë për hartimin e plotë të punimeve, përfshirë vlerësimet financiare që shërbejnë për hartimin e ofertës ekonomike nga operatorët pjesëmarrës.

Në funksion të garantimit të barazisë dhe transparencës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendosi që Autoriteti Portual Durrës të plotësojë dokumentacionin e tenderit me preventivin përkatës, për të siguruar një konkurrim të hapur dhe të drejtë, dhe për të përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e ligjit të prokurimit publik.

Për sa më sipër pranohet ankesa e OE që preventivi të shtohet.

Nr.	Përdhkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Ditë Pune	Çmimi/Njësi	Vlera Vjetore
1	Sheshe te para	m2				
a.	Pastrim 7 ditë në javë me mjete të zakonshme pastrimi	m2	72,024.00	365.00		
b.	Pastrimi dy (2) ditë në javë me mjet teknologjik me fshesë	m2	72,024.00	104.00		
2	Sheshe të dyta	m2				
a.	Pastrim 2 (dy) ditë në javë me mjete të zakonshme pastrimi	m2	199,212.00	104.00		
b.	Pastrimi 1 ditë në javë me mjet teknologjik me fshesë	m2	187,974.00	52.00		
3	Mirëmbajtje e Shesheve te pa sistemuar	m2	69,201.00	365.00		
4	Lagje me ujë e rrugëve për 3 muaj	m2	52,322.00	93.00		
5	Mirëmbajtja e përditshme e konteniereve sanitare	copë	3.00	365.00		
6	Pastrim mirëmbajtje e gropave septike	copë				

a.	PMNZSH	copë	1.00	48.00		
b.	Drejtoria	copë	1.00	12.00		
c.	Oficina	copë	1.00	12.00		
7	Largimi i mbetjeve urbane	m3	15.00	365.00		
8	Pastrimi i njollave të vajit		2.00	12.00		
TOTALI PA TVSH PËR						
TOTALI PA TVSH PËR TRE VITE						

III.1.2. Neni 30 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor dhënë me shkresën nr. 2119 prot, datë 09.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1710/2 prot, datë 11.07.2025, KPP-ja konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, e ka pranuar tërësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “GREEN ENERGY” SHPK për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objket ankimi lidhur me heqjen e kërksës si në vijim: “Licence me kod VII.5.2 “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse”, si dhe lidhur me kërkesën e ankimuesit për publikimin e preventivit të shërbimeve objekt prokurimit, të parashtruara nga ana e në fomularin e ankesës së ankimit me numër ankimi elektronik A/2025/5493 dhe me numër protokolli nr. 1710/2025 prot., datë 30.06.2025, por nuk ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, shtojcën me ndryshimet përkatëse, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “GREEN ENERGY” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për ankesën me nr. 1710/2025 prot., datë 30.06.2025, të operatorit ekonomik “GREEN ENERGY” SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit të shtojcën e datës 02.06.2025 të procedurës së prokurimit prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52166-06-23-2025, me objekt: “Pastrimi i ambjenteve të jashtme të APD-së për 3 vjet”, me fond limit 52.352.379,69 (pesëdhjetë e dy milion e treqind e pesëdhjetë

e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë, presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 534.207,96 (pesëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 25.07.2025, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit, sipas konstatimeve të KSHA-së dhënë me shkresën nr. 2119 prot, datë 09.07.2025.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "GREEN ENERGY" ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

